

Kisha bullgare në Stamboll është vizituar prej 300 mijë vetave për 2 vjet



Mbi 300 mijë veta kanë vizituar Kishën e Hekurt bullgare “Shën Stefani” në Stamboll gjatë 2 vjetëve të fundit. Sipas të dhënave të kryetarit të Fondacionit të Kishave Bullgare në Stamboll Vasill Ljaze, të paktën gjysma e vizituesve të kishës janë turistë bullgarë.

Pas 7 vjetëve të restaurimit, kisha 120-vjeçare u hap më 7 janar 2018. Atëherë në ceremoni morën pjesë Kryeministri bullgar Bojko Borisov dhe Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan.

Tema për përfshirjen e Kishës së Hekurt në Listën e trashëgimisë botërore kulturore të UNESCO-s që ngritur disa herë gjatë vitit të kaluar. Propozimi që prezantuar dhe përpara drejtoreshës së përgjithshme të UNESCO-s Audrey Azoulay gjatë vizitës së saj në Bullgari.